

## JAVA E PARANDALIMIT TË KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS

Java e Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës është një fushatë europiane, e cila ka si qëllim të rrisë informimin dhe ndërgjegjësimin për parandalimin dhe kapjen e hershme të kancerit të qafës së mitrës te femrat.

Shoqata Europiane e Kancerit të Qafës së Mitrës ka nisur organizimin e kësaj fushate në vitin 2002, për të rritur ndërgjegjësimin mbi kancerin e qafës së mitrës dhe për mënyrat se si ai mund të parandalohet. Rritja e ndërgjegjësimit lidhur me depistimin e kancerit të qafës së mitrës dhe vaksinimin kundër HPV-së janë thelbësore për parandalimin dhe reduktimin e kancerit të qafës së mitrës.

Prej vitit 2007, Java Europiane e Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës organizohet çdo vit, javën e fundit të janarit.

Simboli i Fushatës Europiane - STOP Kancerit të Qafës së Mitrës - është “Perla e Mençurisë”.



“Perla e Mençurisë” është një element kyç në këtë fushatë. Qëllimi kryesor i “Perlës së Mençurisë” është që të jetë një simbol i dukshëm për fushatën e kancerit të qafës së mitrës, në mënyrë që njerëzit të mund ta dallojnë lehtë atë ndër të gjitha gjërat e tjera për të cilat kërkohet vëmendja e tyre.

Përdorimi i “Perlës së Mençurisë” është rritur mjaft që kur ajo është prezantuar në janar të vitit 2008, dhe sot shumë organizata e kanë miratuar atë si simbol zyrtar të fushatës së parandalimi të kancerit të qafës së mitrës. Grupe të shumta të pacienteve, organizata të ndryshme të kancerit, shoqata mjekësore etj., e kanë përfshirë “Perlën e Mençurisë” në aktivitetet e parandalimit të kancerit të qafës së mitrës, sepse ajo i ndihmon ata për të térhequr vëmendjen e njerëzve, për të komunikuar në mënyrë efektive me ta, si dhe për t'u kujtuar atyre informacionin që kanë marrë.

*Për më tepër shiko: Kanceri i qafës së mitrës: <http://www.ishp.gov.al/shendet-i-riprodhues/>*